



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM

Nr. 66, datë 1.6.2016

PËR

DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN “MBI MARRËVESHJET E RIBLERJES DHE TË ANASJELLA TË RIBLERJES”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 16, pika 1, dhe nenit 43, shkronja “c” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozim të Departamentit të Operacioneve Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Mbi marrëveshjet e riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes”, miratuar me vendimin nr. 93, datë 13.12.2006 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:
 - a) Në nenin 4, shkronja “k”, togfjalëshi: *“brenda 24 orëve nga njoftimi i”*, zëvendësohet me togfjalëshin: *“të paktën 1 (një) dite pune pas njoftimit të”*.
 - b) Në nenin 5, bëhen ndryshimet e mëposhtme:
 - i. pika 1, shkronja “c” ndryshohet me përmbajtje si vijon: *“marrëveshje me afat maturimi deri në 3 (tre) muaj”*;
 - ii. pika 1, shkronja “d” shfuqizohet;
 - iii. Në pikën 2; togfjalëshi *“në shkronjat “a”, “c” dhe “d”* zëvendësohet me togfjalëshin: *“në shkronjat “a” dhe “c”*”.
 - c) Neni 8 shfuqizohet.
 - d) Në nenin 9 bëhen ndryshimet e mëposhtme:
 - i. Titulli ndryshon në: *“Marrëveshje riblerjeje/e anasjelltë riblerjeje me afat maturimi deri në 3 muaj”*;
 - ii. Pika 1 ndryshon me përmbajtje si vijon: *“Marrëveshja e riblerjes/e anasjelltë e riblerjes me afat maturimi deri në 3-(tre) muaj, është marrëveshja me të cilën Banka e Shqipërisë shet/blen*

tituj, duke marrë përsipër t'i riblejë/t'i rishesë këta tituj pas një periudhe të barabartë me afatin e maturimit, duke nisur prej ditës së hyrjes në fuqi të marrëveshjes.”;

- iii. Në pikat 2, 3 dhe 4, togfjalëshi: “3-(tre) mujor” bëhet: “deri në 3-(tre) muaj”.
 - e) Në nenin 10, pika 2, togfjalëshi: “1 – (një) mujor dhe 3 – (tre) mujor” bëhet: “dhe deri në 3-(tre) muaj”.
 - f) Në nenin 11, pika 1, shkronja “b”, togfjalëshi: “1 – (një) mujor dhe 3 – (tre) mujor” bëhet: “ deri në 3-(tre) muaj”.
 - g) Në nenin 19, pika 4 ndryshon me përmbajtje si më poshtë:

“Çmimi i blerjes së titujve në marrëveshjet e riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes llogaritet sipas formulës së përcaktuar nga Ministria e Financave në dokumentet përkatëse ku bazohet emetimi i tyre.”
 - h) Në të gjithë rregulloren termi: “*letra me vlerë*”, zëvendësohet me termin: “*tituj*”.
2. Ngarkohen Komiteti i Zbatimit dhe Këshillimit të Politikës Monetare, Departamenti i Operacioneve Monetare dhe Departamenti i Sistemit të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës në Bankën e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.
 3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Faqen Zyrtare të Internetit dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë. Ngarkohet Departamenti i Operacioneve Monetare të njoftojë bankat për këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 1 korrik 2016.

SEKRETARI

KRYETARI

Elvis ÇIBUKU

Gent SEJKO